



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE INF.SJP-A

Nr. 1469/4 prot.

Tiranë, më 06/11/2024

Lënda: Jepet Informacion/Dokument i kërkuar (në rrugë elektronike)

ZNJ. J [REDACTED] S [REDACTED]

TIRANË

Në cilësinë e kërkuarit keni depozituar pranë (autoritetit publik), në përputhje me nenin 11, të ligjit 119/2914 "Për të drejtën e informimit" i ndryshuar, kërkesën për dhënie informacioni me numër rendor 4/31.10.2024 (sipas regjistrimit të kërkesave).

Pas shqyrtimit të kërkesës me strukturat përkatëse, bashkangjitur gjeni (informacionin e kërkuar).

Ky informacion Ju është dërguar edhe me email.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin,

Msc Elia PLKU/ADEMI

KORDINATOR

Dr.DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE
UNIVERSITETI I ARTEVE





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI
ZËVENDËSREKTORI

Nr. 1469/prot.
13

Tiranë, më 06.11.2024

Lënda: Kthim përgjigje kërkesës për informacion Nr. 1469 prot., datë 1/11/2024

Tiranë

Në përgjigje të shkresës me lëndë: *Kërkesë për informacioni*, prot 1469, datë 1/11.2024, gjeni bashkëngjitur informacionin e kërkuara sipas pikës 3 (A ka Universiteti i Arteve platformë për dedektimin e plagjiaturës?), ju bëjmë me dije se Universiteti i Arteve nga data 02.05.2023 ka nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi për Bashkëpunim të Ndërsjelltë me Platformën Akademia SH.P.K/Crossplag L.L.C për kontrollin antiplagjiaturë. Bazuar në platformën e sipërpërmendur, kompania Crossplag L.L.C, në varësi të platformës Akademia SH.P.K, do të sigurojë procesin e ndërveprimit, komunikimit dhe kontrollit të dokumenteve për Universitetin e Arteve Tiranë.

Bashëngjitur dokumentacioni

ZËVENDËSREKTOR

Prof. Asoc. Dorian Çene



MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËPUNIM TË NDËRSJELLTË



MAJ 2023

UNIVERSITETI I ARTEVE, TIRANË | PLATFORMA AKADEMIA SH.P.K | CROSSPLAG LLC



MEMORANDUM I MIRËKUPITIMIT PËR BASHKËPUNIM TË NDËRSJELLTË

mes

Universiteti i Arteve, Tiranë

dhe

"Platforma Akademia" L.L.C / Crossplag L.L.C

Më datë 02.05.2023, në mjediset e Universitetit të Arteve Tiranë, u zhvillua takimi institucional midis Universitetit të Arteve Tiranë, përfaqësuar nga Rektori i tij, Prof. Kastriot Çausi

Dhe

Platformës Akademia L.L.C / Crossplag L.L.C, përfaqësuar nga CEO i saj, Z. Besart Kunushevi, për nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit për bashkëpunim të ndërsjelltë.

Në vijim të bisedimeve paraprahe teknike, të dy institucionet impenjohen për sa më poshtë vijon:

I. Qëllimi i Memorandumit

1. Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit palët nënshkruese kanë shprehur vullnetin dhe gatishmërinë për bashkëpunim të ndërsjelltë. Ky memorandum ka për qëllim të përcaktojë bashkëpunimin mes Universitetit të Arteve, Tiranë dhe Platformës Akademia Sh.P.K, Prishtinë në fushën e kontrollit antiplagjiaturë për studentët e Universitetit të Arteve, Tiranë. Platforma Akademia Sh.P.K përmes nënkompanisë së saj Crossplag L.L.C do mundësojë procesin e ndërveprimit, komunikimit dhe kontrollimit të dokumenteve për Universitetin të Arteve, Tiranë.

II. Fusha e veprimtarisë

1. Përmes këtij memorandumi mirëkuptimi rregullohet dhe përcaktohet procesi i kontrollimit antiplagjiaturë të punimeve teorike dhe punimeve të studimeve të doktoraturave për Universitetin e Arteve, Tiranë si dhe i qasjes së kandidatëve të këtij universiteti.
2. Platforma Akademia Sh.P.K, zotohet të ofrojë sistemin antiplagjiaturë përmes markës Crossplag.com në mënyrë që të mbështetet procesi i pagesave përmes kartelave (llogarive) individuale të kandidatëve.
3. Platforma Akademia Sh.P.K zotohet se brenda afatit prej 10 ditë pune nga nënshkrimi i këtij memorandumi nga të dy palët, të ofrojë qasje pa pagesë për Universitetin të Arteve, Tiranë. Kjo qasje nënkupton që Universiteti i Arteve, Tiranë do të ketë qasje në llogarinë "Vlerësues" përmes së cilit kryhen aktivitetet si më poshtë:



REPUBLIKA E SHQIPËS

UNIVERSITETI I ARTEVE

- a. Regjistrimi i kandidatëve të doktoraturës përmes formës së regjistrimit ku duhen ofruar të dhënat bazë mbi kandidatin si: Emri, Mbiemri, Adresa Elektronike dhe gjuhët për kontroll.
 - b. Ofrimi i qasjes në dokumentet e ngarkuara nga studentët dhe të ketë privilegje të vlerësimit të këtyre dokumenteve.
 - c. Shkarkimi i raporteve për përdorim *offline*
 - d. Shkarkimi i certifikatës së ngjashmërisë
 - e. Qasje në statistika
4. Platforma Akademia Sh.P.K zotohet të mundësojë procesin e ngarkimit dhe pagesave individuale për studentët me oferta preferenciale. Rrjedhimisht, çdo kandidat i ftuar nga Universiteti i Arteve Tiranë ka funksionalitetet si në vijim:
- a. *Pranon* ftesën nga Universiteti
 - b. *Aktivizon* llogarinë
 - c. *Kryen* blerjen përmes ofertave:
 - i. Custom – 5,000 fjalë për 8.95€
 - ii. PHD Thesis – 99.99€
 - d. Merr rezultatin pas kontrollit nga vlerësuesit e Universitetit.
5. Në anën tjetër Universiteti i Arteve, Tiranë vlen të theksohet se, *nuk do ketë asnjë implikim financiar si Institucion dhe, rrjedhimisht zotohet që të përdorë Platformën Akademia, respektivisht Crossplag.com, që t'ju mundësojë studentëve të kryejnë kontrollin antiplagjiaturë.*
6. Universiteti i Arteve, Tiranë zotohet se do të ofrojë listën e vlerësuesve (personeli akademik që do të përdorë platformën) në mënyrë që atyre t'ju hapen llogaritë e vlerësimit. Gjithsesi, Platforma Akademia mbetet e hapur, që bazuar në udhëzimet e Rektoratit të Universitetit të Arteve, Tiranë të bëjë çaktivizimin e llogarive të personelit akademik, apo shtimin e përdoruesve të rinj sipas nevojës.
7. Kohëzgjatja e këtij memorandumi është *12 muaj*, me mundësi rinovimi. Në rastin kur Palët nuk njoftojnë ndryshe me shkrim, atëherë rinovimi kryhet në mënyrë të heshtur.

III. Përdorimi i informatave dhe dokumentacioni

I. Palët pajtohen që çdo informacion, dokument apo të dhëna, të shkëmbyera apo të pranuar sipas këtij Memorandumi të Mirëkuptimit, do të përdoren vetëm për qëllime të lejuara dhe brenda përkufizimeve të përcaktuara në këtë dokument. Palët nuk do të shpërndajnë apo bëjnë publike asnjë informacion, dokument apo të dhëna ndonjëherë palë për qëllime tjera, jashtë përkufizimeve të përcaktuara me këtë



Memorandum apo që mund të bien ndesh me frymën e këtij, pa aprovim paraprak të palës tjetër;

- IV. Palët do të përdorin dhe trajtojnë çdo informacion, dokument apo të dhëna si komunikim të ndërsjellë me besueshmëri të plotë;
- V. Çdo mosmarrëveshje, keqkuptim në realizimin e këtij Memorandumi, do të zgjidhet në frymën e tolerancës, mirëkuptimit dhe në bazë të suazave të kodit moral.
- VI. Ky Memorandum hynë në fuqi ditën e nënshkrimit, përpos nëse parashihet ndryshe me marrëveshje nga ana e palëve të përfshira në memorandum.

SHTOJCA E DOKUMENTEVE

Bashkëngjitur me këtë Memorandum janë edhe dokumentet përcjellëse si në vijim:

- 1. Oferta e aprovuar
- 2. Udhëzuesi i përdorimit për llojin e llogarisë "Vlerësues"
- 3. Udhëzuesi i përdorimit për llojin e llogarisë "Student"
- 4. Lista për informata rreth vlerësuesve

PALET NËNSHKRUESE

Universiteti i Arteve, Tiranë

Prof. Kastriot CAJSHI
Rektor
Tiranë, më 02.05.2023

Nënshkrimi dhe Vula

Platforma Akademia Sh.P.K / Crossplag
L.L.C

Besart KUNUSHEVCI
Drejtor Ekzekutiv
Për Besartin

Nënshkrimi dhe Vula





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
ZËVENDËSREKTORI

Nr. 1469 / Prot. 12

Tiranë, më 06.11.2024

Lënda: Përgjigje kërkesës për informacion me nr. 1469 prot., datë 01.11.2024

Të nderuar,

Në përgjigje të shkresës me lëndë: Kërkesë për informacion, prot. 1469, dt.01.11.2024, gjeni bashkëngjitur informacionin e kërkuar sipas pikës nr. 4.

4. Cilat janë bibliotekat digjitale ku stafi akademik dhe studentët e universitetit kanë akses?

Biblioteka e Universitetit të Arteve është një nga Bibliotekat e para Universitare në Shqipëri që ka përdorur shërbimin e burimeve elektronike për përdoruesit e saj, studentë dhe pedagogë, prej vitit 2007, nëpërmjet donacioneve dhe projekteve duke qenë pjesë e Konsortiumit Eifel.net., Konsortium European i mbështetur nga Këshilli i Europës

Aksesi në burimet elektronike në Bibliotekën e Universitetit të Arteve janë:

- International Music Score Library Project – Petrucci Music Library. Online library.
<https://imslp.org/>
- JSTOR digital library.
<https://about.jstor.org/library-advisory-group/>

(në proces negocimi me AADF për të përfutur akses të lirë për studentët dhe pedagogët Universiteti të Arteve)

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

ZËVENDËSREKTORI

Prof. Arian Paço

